



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

Nr. 15435 /  
Prot. /  
/

Tiranë, më 4/12 2014

URDHËR

Nº 96 dt 4.12.14.

PËR

MIRATIMIN E “RREGULLORES SË MBAJTJES SË UNIFORMËS  
PËR SHËRBIMIN DOGANOR”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 102/2014 datë 31. 7. 2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të vendimit nr. 292, datë 14. 5. 2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e uniformës dhe të emblemës së shërbimit doganor”, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, Ministri i Financave,

U r d h ë r o n:

1. Miratimin e rregullore “Për mbajtjen e uniformës për shërbimin doganor”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhëri.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e kësaj rregulloreje.
3. Rregullorja Nr.3922/7 Prot., datë 9.10.2001, e Ministrit të Financave për uniformën e personelit të administratës doganore, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të administratës doganore.

Shkëlqim CANI

  
MINISTËR I FINANCAVE

## **RREGULLORJA**

### **“PËR MBAJTJEN E UNIFORMËS PËR SHËRBIMIN DOGANOR SHQIPTAR”**

#### **I. TË PËRGJITHSHME**

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave të mbajtjes së uniformës nga punonjësit e administratës doganore. Mbajtja e rregullt e uniformës përbën respekt për publikun, përfaqësim dinjitoz për institucionin shtetëror, ndikon mbi idenë që publiku krijon për shërbimin doganor, si dhe në mënyrën se si punonjësi doganor i përmbush funksionet zyrtare.
2. Punonjësit e shërbimit doganor pajisen me uniformë dhe me mjete apo pajisje të tjera, si: armë, tabela e shenja të nevojshme për të kryer detyrat.
3. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave përcakton kategoritë e personelit doganor që mbajnë uniformë shërbimi, trajtimin e rasteve kur është e nevojshme të veprohet pa uniformë, kategoritë e personelit doganor, që mbajnë uniformë ceremoniale dhe eventet kur mbahet kjo uniformë, si dhe kategoritë e personelit doganor që mund të pajisen me armë.
4. Uniformat e shërbimit dhe uniformat ceremoniale kanë shenja dalluese nga njëra-tjetra.
5. Karakteristikat, forma, kompozicioni, ngjyrat, simbolet, emblema e uniformave të punonjësve doganorë janë sipas përcaktimeve në vendimin nr. 292, datë 14. 5. 2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e uniformës dhe të emblemës së shërbimit doganor”.
6. Uniforma u jepet punonjësve pa pagesë.
7. Afati i përdorimit të uniformës jepet në *Aneksin I*, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
8. Punonjësit me uniformë të administratës doganore janë të detyruar ta mbajnë e ta përdorin uniformën në përputhje me rregullat e shërbimit.

#### **II. TË VEÇANTA**

1. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre doganore, është e domosdoshme mbajtja e uniformës së shërbimit nga punonjësit e doganës të ngarkuar me mbajtjen e saj.
2. Strukturat që përdorin jelekë dhe elementë të tjerë të natyrës operacionale, i mbajnë ato në rastet kur dërgohen me shërbim për kryerje kontrollesh, me qëllim që të jenë të identifikuar.
3. Për raste të veçanta ceremoniale, personeli drejtues i doganës mban uniformë ceremoniale, e cila është ndërtuar mbi bazën e uniformës së shërbimit.

4. Në ndryshim nga përcaktimet e pikës 1, më lart, kur për shkak të specifikave të shërbimit doganor është e domosdoshme për interesa të punës të veprohet pa uniformë, drejtuesit e strukturave doganore mund të nxjerrin urdhër për punonjësit në varësi të tyre, për mbajtjen e veshjeve civile apo mospërdorimin e uniformës gjatë shërbimit.  
Në këto raste punonjësi doganor duhet të paraqesë dokumentin e identifikimit të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

### **III. PARAQITJA E UNIFORMËS**

1. Paraqitja e uniformës që mban punonjësi i administratës doganore si përfaqësues i shtetit duhet të jetë sipas karakteristikave dhe pamjes së dhënë në katalogun përkatës, e cila tërhiqet pranë Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës në DPD.
2. Mbi uniformë nuk mund të vendosen sende të tjera përveç atyre që bëjnë pjesë në pajisjet ndihmëse në funksion të kryerjes së detyrës. Nuk lejohet mbajtja e elementëve të dukshëm si zbukurime, zinxhirë, medaljone, etj., që çënojnë pamjen e uniformës.
3. Uniforma duhet të jetë e rregullt, e pastër dhe e plotë.
4. Kapelja e çdo lloji, për uniformën që e ka pjesën të sajën, gjatë ushtrimit të detyrës në zyrë, ose gjatë qëndrimit në makinë mund të hiqet, ndërsa jashtë tyre uniforma duhet të jetë e plotësuar. Kapelja mbahet drejt në kokë dhe aq poshtë mbi ballë sa të mbulojë flokët.
5. Gjatë ushtrimit të detyrës personeli me uniformë duhet të përdorë vetëm ato sende private që janë të nevojshme dhe që duhet të përdoren detyrimisht.
6. Mbajtja e flokëve, mjekrës nuk duhet të çënojnë paraqitjen e uniformës.
5. Personelit me uniformë i ndalohet mbajtja e sendeve zbukuruese që çënojnë seriozitetin e uniformës, të tilla si, zinxhirë/varëse të rënda në qafë, byzylykë të rëndë dore dhe byzylykë këmbë, etj.

### **IV. PËRGJEGJËSIA E PËRDORIMIT DHE/OSE DËMTIMIT TË UNIFORMËS**

- ~~1. Drejtuesit e çdo niveli janë përgjegjës për mbarevajtjen e përdorimit të uniformës nga punonjësit doganorë në varësi, në përputhje me ushtrimin e detyrës:~~
2. Nëse uniforma dëmtohet në rrethana që kanë lidhje direkte me ushtrimin e detyrës, ndërkohë që punonjësi ka treguar kujdes për ruajtjen e tyre, shpenzimet për zëvendësimin e saj mbulohen nga administrata doganore.
3. Nëse uniforma dëmtohet nga vetë punonjësi dhe dëmtimi nuk ka lidhje direkte ose shkakësore me kryerjen shërbimit doganor ose punonjësi nuk ka treguar kujdesin e duhur për ruajtjen e tyre, atëherë punonjësit i ngarkohen shpenzimet financiare në vlerën që nevojitet për zëvendësimin e saj.

## V. NDALIMI I MBAJTJES SË UNIFORMËS

1. Ndalohet mbajtja e uniformës, kur nga përdorimi i saj mund të çenohet imazhi i administratës doganore.
2. Përdorimi i uniformës ndalohet:
  - a) jashtë shërbimit, me përjashtim të rrugës nga shtëpia në punë dhe anasjelltas;
  - b) kur paraqitesh në gjyq ose para një organi administrativ jo si përfaqësues i administratës doganore;
  - c) gjatë lejes administrative;
  - ç) në aktivitete të ndryshme jashtë shtetit, me përjashtim të rasteve kur urdhërohet ndryshe;
  - d) gjatë pezullimit nga detyra;
  - dh) pas largimit nga detyra.
3. Uniforma apo pjesët e saj nuk mund të përdoren nga askush tjetër përveçse nga personi të cilit i janë dhënë për ushtrimin e detyrës.

## VI. TËRHEQJA DHE DORËZIMI I UNIFORMËS

1. Tërheqja dhe dorëzimi i uniformës bëhet pranë Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës (magazinës) në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Punonjës pranë kësaj strukture, ku përfshihet edhe magazinieri verifikojnë pozicionin e punës së punonjësit dhe vijnë më pas me dhënien e uniformës së re dhe/ose pranimin e marrjes në dorëzim të uniformës së vjetër.
2. Punonjësi doganor i ngarkuar me mbajtjen e uniformës e dorëzon atë në rastet kur:
  - a) ndryshon pozicionin e punës në një pozicion ose kategori tjetër, që nuk parashikon mbajtjen e uniformës.
  - b) dëmtohet uniforma në përdorim të tij;
  - c) plotësohet afati i mbajtjes së uniformës;
  - ç) në rast largimi nga puna.
3. Në rastin e pranimit ose jo të marrjes në dorëzim të uniformës së vjetër, punonjësit e caktuar pranë Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës në DPD përfshirë magazinierin, në prani të punonjësit doganor që paraqitet për dorëzimin e uniformës harton një procesverbal për këtë qëllim, i cili nënshkruhet nga këta punonjës. Në procesverbal përshkruhen të dhëna për datën, punonjësing që paraqitet për dorëzimin e uniformës, arsyet e dorëzimit, gjendja e uniformës duke përshkruar dëmtimet, shoqëruar edhe me foto, etj.
4. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave vlerëson shkallën e dëmtimit apo amortizimit të uniformës dhe marrjen në dorëzim të saj, me qëllim që të bëhet zëvendësimi ose jo i saj.

5. Kjo strukturë hap dhe depoziton kartelën e veshmbathjes së punonjësit me uniformë, e cila duhet të përmbajë masat trupore të gjithsecilit dhe pajisjet periodike të punonjësit me veshmbathjet e uniformës.

## ANEKSII

### Afatet e përdorimit të uniformës doganore

a) Afatet e përdorimit për uniformën e shërbimit doganor për meshkuj:

Nr.	Uniforma e shërbimit	Njësia matëse	Sasia	Përdorimi në vite shërbimi
1.	Kostum (xhaketë + 2 palë pantallona)	komplet	1	1
2.	Kravate	copë	2	1
3.	Këmishë me mëngë te gjata	copë	4	1
4.	Këmishë me mëngë te shkurtra	copë	4	1
5.	Pulovër	copë	1	1
6.	Këpucë	palë	2	1
7.	Rrip pantallonash	copë	1	1
8.	Xhup për dimër	copë	1	1

b) Afatet e përdorimit për uniformën e shërbimit doganor për femra:

Nr.	Uniforma e shërbimit	Njësia matëse	Sasia	Përdorimi në vite shërbimi
1.	Kostum (xhaketë + 2 palë pantallona + 2 funde)	komplet	1	1
2.	Kravate/shall	copë	2	1
3.	Këmishë me mëngë te gjata	copë	4	1
4.	Këmishë me mëngë te shkurtra	copë	4	1
5.	Pulovër	copë	1	1
6.	Këpucë	palë	2	1
7.	Rrip pantallonash	copë	1	1
8.	Xhup për dimër	copë	1	1

c) Afatet e përdorimit për uniformën ceremoniale:

Nr.	Uniforma	Njësia matëse	Sasia	Përdorimi në vite shërbimi
1.	Kostum (xhaketë + 2 palë pantallona + 2 funde)	komplet	1	2
2.	Kapele	copë	1	2

3.	Kravate/shall	copë	2	2
4.	Këmishë me mëngë te gjata	copë	4	2
5.	Këpucë	palë	1	1
6.	Rrip pantallonash	copë	1	2

ç) Afatet e përdorimit për uniformën e shërbimit doganor të strukturave operationale (antikontrabanda):

Nr.	Uniforma e shërbimit	Njësia matëse	Sasia	Përdorimi në vite shërbimi
1.	Xhakavento	komplet	1	1
2.	Pantallona	komplet	1	1
3.	Këmishë me mëngë te gjata	copë	4	1
4.	Këmishë me mëngë te shkurtra/bluzë polo me mëngë të shkurtra	copë	4	1
5.	Pulovër	copë	1	1
6.	Triko- golf	copë	1	1
7.	Jelek sportiv	copë	1	1
8.	Këpucë	palë	2	1
9.	Rrip pantallonash	copë	1	1
10.	Kapele	copë	2	1
11.	Xhup për dimër	copë	1	1